

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “Kukës International Airport” sh.p.k është një shoqëri e themeluar më datë 31.01.2019 në përmbushje të kushteve të kontratës së koncesionit”, të lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si Autoriteti Kontraktor, si dhe bashkimit të shoqërive “Global Technical Mechanics” shpk dhe “Bami” shpk si Koncesionari, dhe “Kukes International Airport” si Shoqeria Koncesionare.

Kjo marrëveshje është miratuar me Vendimin të Këshillit të Ministrave me Nr. 146, datë 20.3.2019, publikuar në Fletoren zyrtare me Nr. 41, Datë 28.03.2019, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

“Shoqëria” është subjekt i themeluar me qëllim të vecantë dhe ka objekt vëmprimtarie “Rehabilitimin, Operimin dhe Transferimin e Aeroportit të Kukësit, si dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjetër të nevojshëm, ndihmës apo plotësues në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së këtij objekti.

Periudha e koncesionit fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon në datën e përfundimit të tij (“Periudha e Koncesionit”). Periudha e koncesionit është 35 (tridhjetë e pesë) vjet.

Kapitali i shoqërisë “Kukës International Airport” sh.p.k. është 10,000,000 Lekë.

Kukës International Airport është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortakë si më poshtë:

- “Global Technical Mechanics” shpk, zotëruese e 100% të kapitalit të shoqërisë.

Numri i punonjësve të shoqërisë më 31 dhjetor 2023 është 37 persona, (31 dhjetor 2022: 77 persona).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon përdorimin e disa vlerësimeve të rëndësishme kontabël dhe kërkon gjithashtu që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij gjatë zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Shoqëria mëmë ka deklaruar angazhimin e saj nëpërmjet një letre mbështetjeje të lëshuar më 3 prill, 2024, për të vazhduar mbështetjen e Shoqërisë me kapital të mjaftueshëm punues dhe financim në të ardhmen e parashikueshme për 12 muajt në vijim.

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përkrahur më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatit e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2023 dhe më 31 dhjetor 2022 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2023	2022
EUR/LEK	103.88	114.23
USD/LEK	93.94	107.05

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2023 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Mobilje për zyren	Vlerë e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Instrumenta the vegla pune	Vlerë e mbetur	20 %

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktivet e patrupëzuara

(i) Marrëveshja e shërbimit koncesionar

Shoqëria njih një aktiv të patrupëzuar që rrjedh nga kontrata e shërbimit të koncesionit kur ka të drejtë të faturojë përdoruesit e infrastrukturës koncesionare. Aktivet e patrupëzuara njihen fillimisht me kosto, që është vlera e drejtë e pagesës për të drejtën për të ofruar shërbime aeroportuale sic përcaktohet në marrëveshjen e koncesionit. Pas njohjes fillestare, aktivi i patrupëzuar matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, nëse ka.

Sipas kerkesave të SKK 5, paragrafi 24, b, Shoqëria ka aplikuar njohjen e aktivit sipas Modelit të aktivit jo-material. Keshtu Shoqëria fillimisht, ka njohur një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën për të tarifuar përdoruesit e shërbimit publik.

(ii) Njohja e Koncesionit

Shoqëria ka njohur fillimisht aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Fillimisht ajo ka njohur një aktiv jomaterial me kosto. Kostoja e një aktivi afatgjatë jo-material të blerë përfshin:

- a) çmimin e tij të blerjes, duke përfshirë taksat e importit dhe taksat e parimbursueshme të blerjes, duke zbritur skontot dhe zbritjet tregtare; dhe
- b) çdo kosto që i ngarkohet drejtpërdrejt përgatitjes së aktivit për përdorimin e tij të paramenduar.

Shoqëria ka njohur shpenzimet e kryera brenda saj për krijimin e një aktivi jo-material, duke përfshirë të gjitha shpenzimet për aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit, si një shpenzim në periudhën kur janë kryer.

(iii) Vlerësimi i mëpasshëm

Koncesioni do të paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi për çdo periudhë do të njihet si një shpenzim, përveç nëse një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e koston së një aktivi tjetër.

Amortizimi fillon kur aktivi jomaterial është i disponueshëm për përdorim, p.sh. kur ai është në vendin dhe në kushtet e domosdoshme për të qënë i përdorshëm sipas mënyrës së menduar nga drejtuesit. Amortizimi pushon kur aktivi çregjistrohet.

Amortizimi i Koncesionit është njohur me metoden lineare dhe aplikohet për kohezigjatjen 35 vjet, aq sa është edhe kohezigjatja e Kontrates së Koncesionit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Aktivitetet më të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.14. Aktivitetet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundur që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3.15. Përfitimet e punonjësve

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

3.16. Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes, që janë direkt të lidhura me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat janë aktive që marrin kohë që të jenë gati për t'u përdorur, i janë shtuar kostos së këtyre aktiveve, deri në periudhën që aktivet janë gati për përdorim apo shitje.

Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (fitim ose humbje) në periudhën në të cilën ndodhin.

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Mjete monetare në bankë	1,783,972	1,405,137
Banka ne Leke	923,942	605,127
Banka ne valute te huaj	860,030	800,010
Mjete monetare në arkë	101,745	90,678
Arka ne leke	78,242	28,450
Arka ne valute te huaj	23,503	62,228
	<u>1,885,717</u>	<u>1,495,815</u>

5. Te drejta te arketueshme

Te drejta te arketueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Te arketueshme nga klientet	52,739,189	30,111,648
Te arketueshme nga pale te lidhura	1,558,200	1,713,450
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	-	-
	<u>54,297,389</u>	<u>31,825,098</u>

6. Te tjera te arketueshme

Të tjera të arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
TVSH e kreditueshme	504,888	365,789,801
Parapagime	2,231,196	9,914,605
Te tjera te arketueshme	3,843,560	4,226,509
	<u>6,579,644</u>	<u>379,930,915</u>

7. Inventarët

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Materiale dhe Lëndë të para	137,966	19,685
Mallra duty free	511,095	8,993,958
Mallra lokali	35,865	18,326
	<u>684,926</u>	<u>9,031,969</u>

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

8. Garanci

Garanci detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Garanci afatshkurter	5,000,000	5,000,000
Garanci afatgjate	28,463,120	31,299,020
	<u>33,463,120</u>	<u>36,299,020</u>

Si më poshtë të detajuara sipas monedhës:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Garanci bankare Leke	5,000,000	5,000,000
Garanci bankare Euro	28,463,120	31,299,020
	<u>33,463,120</u>	<u>36,299,020</u>

Garancite, kane te bejne me garanci bankare te vendosura prane Bankave te nivelit te dyte ne lidhje me marreveshjen koncesionare sipas Nenit 8.1 te saj

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Shpenzime të shtyra - Projekte	159,290	145,330
Shpenzime të shtyra - Siguracion	-	9,041
Shpenzime të shtyra – Sherbime financiare	120,000	-
	<u>279,290</u>	<u>154,371</u>

Kukës International Airport Sh.p.k**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023***(Vlerat janë në Lek)***10. Aktive afatgjata materiale**

	Mobilje dhe orendi	Kompjutera	Mjete transporti	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>					
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	5,875,678	21,478,864	8,063,635	21,259,589	56,677,766
Shtesa	2,912,417	302,237	-	8,928,851	12,143,505
Gjëndja më 31 Dhjetor 2022	8,788,095	21,781,101	8,063,635	30,188,440	68,821,271
Shtesa	-	35,850	-	1,690,826	1,726,676
Gjëndja më 31 Dhjetor 2023	8,788,095	21,816,951	8,063,635	31,879,266	70,547,947
<i>Amortizimi i akumuluar</i>					
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	(651,001)	(2,971,324)	(2,685,554)	(1,990,963)	(8,298,842)
Amortizimi i vitit	(1,500,379)	(4,669,573)	(1,075,616)	(4,816,421)	(12,061,989)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2022	(2,151,380)	(7,640,897)	(3,761,170)	(6,807,384)	(20,360,831)
Amortizimi i vitit	(3,587,001)	(1,707,552)	(860,493)	(5,183,510)	(11,338,556)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2023	(5,738,381)	(9,348,449)	(4,621,663)	(11,990,894)	(31,699,387)
<i>Vlera neto kontabël</i>					
Gjendja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	5,224,677	18,507,540	5,378,081	19,268,626	48,378,924
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	6,636,715	14,140,204	4,302,465	23,381,056	48,460,440
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	3,049,714	12,468,502	3,441,972	19,888,372	38,848,560

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

11. Aktive afatgjata jo-materiale

	Jo-materiale	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	7,733,399	7,733,399
Shtesa	35,970	35,970
Pakesime	(2,169,489)	(2,169,489)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2022	5,599,880	5,599,880
Shtesa	-	-
Pakesime	-	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2023	5,599,880	5,599,880
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	(15,950)	(15,950)
Amortizimi i vitit	(835,357)	(835,357)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2022	(851,307)	(851,307)
Amortizimi i vitit	(11,944)	(11,944)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2023	(863,251)	(863,251)
<i>Vlera neto kontabël</i>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	7,717,449	7,717,449
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	4,748,573	4,748,573
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	4,736,629	4,736,629

12. Aktive afatgjata jo-materiale, Koncesioni

	Koncesioni	Totali
<i>Kosto</i>		
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	1,518,616,950	1,518,616,950
Shtesa	249,656,401	249,656,401
Gjëndja më 31 Dhjetor 2022	1,768,273,351	1,768,273,351
Shtesa	7,653,411	7,653,411
Gjëndja më 31 Dhjetor 2023	1,775,926,762	1,775,926,762
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
Gjëndja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	-	-
Amortizimi i vitit	(36,935,214)	(36,935,214)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2022	(36,935,214)	(36,935,214)
Amortizimi i vitit	(55,647,730)	(55,647,730)
Gjëndja më 31 Dhjetor 2023	(92,582,944)	(92,582,944)
<i>Vlera neto kontabël</i>		
Gjendja më 31 Dhjetor 2021 - Të pa-audituar	1,518,616,950	1,518,616,950
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	1,731,338,137	1,731,338,137
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	1,683,343,818	1,683,343,818

12. Aktive afatgjata jo-materiale, Koncesioni (vazhdim)

Shoqëria “Kukës International Airport” sh.p.k është një shoqëri e themeluar më datë 31.01.2019 në përmbushje të kushteve të kontratës së koncesionit”, të lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si Autoriteti Kontraktor, si dhe bashkimit të shoqërive “Global Technical Mechanics” shpk dhe “Bami” shpk si Koncesionari, dhe “Kukes International Airport” si Shoqëria Koncesionare.

Kjo marrëveshje është miratuar me Vendimin të Këshillit të Ministrave me Nr. 146, datë 20.3.2019, publikuar në Fletoren zyrtare me Nr. 41, Datë 28.03.2019, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

“Shoqëria” është subjekt i themeluar me qëllim të vecantë dhe ka objekt vëmprimitarie “Rehabilitimin, Operimin dhe Transferimin e Aeroportit të Kukësit, si dhe kryerjen e cdo aktiviteti tjetër të nevojshëm, ndihmës apo plotësues në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së këtij objekti.

Periudha e koncesionit fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe përfundon në datën e përfundimit të tij (“Periudha e Koncesionit”). Periudha e koncesionit është 35 (tridhjetë e pesë) vjet.

Vlera e njohur si Aktiv afatgjate jo-materiale, Koncesion ka të bëjë me investimet e kryera për rehabilitimin, dhe operimin e Aeroportit të Kukësit përgjatë viteve 2023 dhe 2022, nga Shoqëria. Keto punime janë kryer nga Shoqëria pale e lidhur Global Technical Mechanics.

Shoqëria ka filluar të amortizojë vlerën e aktivitet afatgjate jo-material në vitin 2022, pas fillimit të operimit të Aeroportit të Kukësit, me metoden lineare, dhe me një jetegjatesi aktivi prej 35 vitesh, sa është edhe kohezigjatja e Kontrates së Koncesionit.

Në përfundim të kohezigjatjes së Kontrates së Koncesionit, Shoqëria Koncesionare, ka detyrimin të kthejë pranë Autoritetit Kontraktor, aktivin e rehabilituar, në gjendje të mirë dhe funksionale, sipas përcaktimeve në kontratë.

Vlera e mbetur e Koncesionit më 31 dhjetor 2023 është 1,683,343,818 Lek (31 dhjetor 2022: 1,731,338,137 Lek).

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

13. Hua

Huatë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Hua afatshkurter	201,196,672	395,074,730
Hua afatgjate	743,108,000	861,735,000
Interesa te perllogaritur	-	-
	944,304,672	1,256,809,730

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Hua nga Auto Star Albania	12,047,287	11,220,053
Hua nga Global Technical Mechanics	117,098,442	319,862,677
Hua nga Raiffeisen Bank	467,458,943	559,727,000
Hua nga Tirana Bank	347,700,000	366,000,000
	944,304,672	1,256,809,730

Shoqeria ka marre kredi nga bankat e nivelit te dyte si vijon:

1. Kredi bankare nga Raiffeisen Bank, sipas kontrates se dates 29 mars 2021, ne vleren 5,000,000 EUR. Kjo kredi do te perdoret per qellime te rehabilitimit te Aeroportit te Kukesit, me afat shlyerje deri me 20 prill 2029, dhe norme efektive te interest 6.32%.
2. Kredi bankare nga Tirana Bank, sipas kontrates se dates 8 tetor 2022, ne vleren 366,000,000 Lek. Kjo kredi do te perdoret per qellime te investimit ne Aeroportin e Kukesit, me afat shlyerje deri me 28 shtator 2029, dhe norme efektive te interest 8.35%.

14. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Te pagueshme ndaj paleve te treta	70,854,274	82,851,615
Te pagueshme ndaj paleve te lidhura	1,190,144,537	1,180,592,805
	1,260,998,811	1,263,444,420

Te pagueshme ndaj paleve te lidhura ne vleren 1,190,144,537 Lek (31 dhjetor 2022: 1,180,592,805 Lek), kane te bejne me financime afatshkurtra per qellim te aktivitetit operacional te Aeroportit dhe detajohen si vijon:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2022
Te pagueshme ndaj Global Technical Mechanics	1,178,993,354	1,169,932,640
Te pagueshme ndaj Ridgers Mema	11,151,183	10,660,165
	1,190,144,537	1,180,592,805

15. Te pagueshme per detyrime tatimore

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

Te pagueshme per detyrime tatimore më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	744,564	2,754,535
Tatimi mbi të ardhurat personale	302,886	865,712
Tatim në burim	43,899	23,552
Te tjera	-	38,847
	<u>1,091,349</u>	<u>3,682,646</u>

16. Te tjera te pagueshme

Te tjera te pagueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Detyrime ndaj personelit	3,719,757	4,433,080
Detyrime per dieta	85,980	85,980
	<u>3,805,737</u>	<u>4,519,060</u>

17. Kapitali

Kapitali i shoqërisë “Kukës International Airport” sh.p.k. është 10,000,000 lekë, dhe zoterohet si vijon:

	<u>31 dhjetor 2023</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
Global Technical Mechanics shpk	100%	100%
	<u>100%</u>	<u>100%</u>

18. Të ardhurat

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>
Sherbime aeroportuale	20,155,436	44,712,777
Te ardhura nga qiraja	9,532,357	14,795,577
Sherbime internet	44,000	559,640
Sherbim hapësira parkimi	720,000	3,240,000
Te ardhura nga transporti	3,915,329	-
Sherbim Logjistike	15,438,523	-
Te ardhura nga marketing	-	6,061,302
Te ardhura nga duty free	279,704,576	8,979,258
Te ardhura nga lokali	913,950	1,172,757
	<u>330,424,171</u>	<u>79,521,311</u>

19. Shpenzime personeli

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

Shpenzime personeli detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime për paga	57,615,495	71,179,017
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,185,895	11,108,107
	66,801,390	82,287,124

20. Shpenzime operative

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime per permiresim te aeroportit	17,211,188	40,367,406
Shpenzime per mirembajtje te software sas	-	10,131,578
Shpenzime certifikime	5,645,300	6,504,200
Ruajtja e objekteve	4,863,130	5,074,567
Shpenzime marketingu dhe promocionesh	-	3,802,737
Shpenzime Udhëtimi dhe dieta	2,667,707	3,158,943
Shpenzim studim fizibiliteti	-	2,839,320
Shpenzime per tarifen kombetare	1,191,458	2,559,080
Mirembajtje dhe riparime	4,361,085	2,091,479
Shpenzime per pritje percjellje	198,301	1,484,971
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,279,559	1,458,097
Qera	1,192,938	1,157,642
Trajnim personeli	464,404	1,029,100
Shërbime konsulencash	-	730,239
Kancelari	161,997	581,024
Gjoha dhe kamatvonesa	835,023	549,191
Shpenzime sigurimi	367,932	540,625
Komisione Bankare	290,128	300,605
Shpenzime pastrimi	-	114,067
Taksa dhe tarifa	82,941	60,744
Shpenzime te tjera	5,209,627	2,216,320
	46,022,718	86,751,935

21. Kosto e materialeve

Kukës International Airport Sh.p.k**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023***(Vlerat janë në Lek)*

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	250,767,095	15,497,546
Energji, uje dhe te tjera	4,104,853	11,860,590
Materiale te pastokueshme	213,539	274,022
	255,085,487	27,632,158

22. Shpenzime per interesa

Në këtë zë paraqiten shpenzimet e interesave per huamarrjet bankare dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime per interesa	(65,047,582)	(33,639,574)
	(65,047,582)	(33,639,574)

23. Fitimi nga kurset e kembimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime nga këmbimet valutore	(11,157,081)	(3,376,565)
Të ardhura nga këmbimet valutore	79,778,359	44,123,958
	68,621,278	40,747,393

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Kukës International Airport Sh.p.k**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023***(Vlerat janë në Lek)*

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
<i>Humbja para tatimit</i>	<i>(100,909,958)</i>	<i>(159,874,647)</i>
Shpenzime të panjohura	3,615,670	2,449,289
Shpenzime per pritje percjellje	-	556,341
Penalitete, gjoha e dëmshpërblime	835,023	549,191
Dhurata	-	19,885
Shpenzime të tjera	2,780,647	1,323,872
Interes i pazbritshem	62,292,218	32,568,951
<i>Humbja para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)</i>	<i>(35,002,070)</i>	<i>(124,856,407)</i>
<i>Tatim fitimi 15%</i>	-	-

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

25. Shenimet e rrezikut financiar

a) Rreziku i normës së interes

Rreziku i normës së interesit është i përbërë nga rreziku që vlera e instrumentit financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rreziku që maturimet e aseteve me interes ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve me interes, detyrimet të cilat përdoren për të financuar këto aktive. Gjatësia e kohës për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon se deri në çfarë mase është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë mbartin normat e interesit të tregut. Shoqëria ka detyrime afatgjatë huaje të konsideruar si detyrim me interes, ndërkohë që ajo nuk ka depozita afatshkurtra dhe afatgjata me interes.

b) Rreziku i kredisë

Shoqëria nuk konsiderohet e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë të cilat do ndikojnë në pozicionin dhe performancën e saj financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023.

c) Rreziku i likuiditetit

Shoqëria nuk ka ekspozim të konsiderueshëm ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare janë të kufizuara për detyrime të pagueshme tregtare gjatë rrjedhës normale të biznesit dhe për detyrimet e pagueshme ndaj Shoqërisë mëmë.

Maturimi kontraktual i aktiveve dhe detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor, 2023	Vlera neto	0-3 muaj	3-12 muaj	Mbi 12 muaj
<i>Aktive financiare</i>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to	1,885,717	1,885,717	-	-
Llogari të arkëtueshme	54,297,389	54,297,389	-	-
Te tjera te arkëtueshme	6,579,644	6,579,644	-	-
Garanci	33,463,120	-	5,000,000	28,463,120
Totali	96,225,870	62,762,750	5,000,000	28,463,120
<i>Detyrime financiare</i>				
Hua	944,304,672	18,794,608	182,402,064	743,108,000
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	1,260,998,811	1,260,998,811	-	-
Te pagueshme per detyrime tatimore	1,091,349	1,091,349	-	-
Te tjera te pagueshme	3,805,737	3,805,737	-	-
Totali	2,210,200,569	1,284,690,505	182,402,064	743,108,000
Hendeku i likuiditetit	(2,113,974,699)	(1,221,927,755)	(177,402,064)	(714,644,880)

25. Shenimet e rrezikut finaciuar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor, 2022	Vlera neto	0-3 muaj	3-12 muaj	Mbi 12 muaj
<i>Aktive financiare</i>				
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to	1,495,815	1,495,815	-	-
Llogari të arkëtueshme	31,825,098	31,825,098	-	-
Te tjera te arketueshme	379,930,915	379,930,915	-	-
Garanci	36,299,020	-	5,000,000	31,299,020
Totali	449,550,848	413,251,828	5,000,000	31,299,020
<i>Detyrime financiare</i>				
Hua	1,256,809,730	18,082,668	376,992,062	861,735,000
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	1,263,444,420	1,263,444,420	-	-
Te pagueshme per detyrime tatimore	3,682,646	3,682,646	-	-
Te tjera te pagueshme	4,519,060	4,519,060	-	-
Totali	(2,528,455,856)	(1,289,728,794)	(376,992,062)	(861,735,000)
Hendeku i likuiditetit	(2,078,905,008)	(876,476,966)	(371,992,062)	(830,435,980)

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

25. Shenimet e rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i monedhes

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës së huaj më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 paraqitet si vijon:

31 dhjetor 2023	Vlera neto	EUR	USD	GBP	LEK
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to	1,885,717	883,533	-	-	1,002,184
Llogari të arkëtueshme	54,297,389	49,216,989	-	-	5,080,400
Te tjera te arketueshme	6,579,644	3,844,560	-	-	2,735,084
Garanci	33,463,120	28,463,120	-	-	5,000,000
Hua	(944,304,672)	(732,632,172)	-	-	(211,672,500)
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	(1,260,998,811)	(46,883,464)	(9,958)	(97,965)	(1,214,007,424)
Te pagueshme per detyrime tatimore	(1,091,349)	-	-	-	(1,091,349)
Te tjera te pagueshme	(3,805,737)	-	-	-	(3,805,737)
Totali	(2,113,974,699)	(697,107,434)	(9,958)	(97,965)	(1,416,759,342)

31 dhjetor 2022	Vlera neto	EUR	USD	GBP	LEK
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to	1,495,815	862,418	-	-	633,397
Llogari të arkëtueshme	31,825,098	27,014,064	-	-	4,811,034
Te tjera te arketueshme	379,930,915	11,879,919	-	-	368,050,996
Garanci	36,299,020	31,299,020	-	-	5,000,000
Hua	(1,256,809,730)	(770,894,177)	-	-	(485,915,553)
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	(1,263,444,420)	(45,067,900)	(605,475)	(105,714)	(1,217,665,331)
Te pagueshme per detyrime tatimore	(3,682,646)	-	-	-	(3,682,646)
Te tjera te pagueshme	(4,519,060)	-	-	-	(4,519,060)
Totali	(2,078,905,008)	(744,906,656)	(605,475)	(105,714)	(1,333,287,163)

Analiza e ndjeshmerise per monedhat e huaja

Analiza e mëposhtme e ndjeshmërisë është përcaktuar duke u bazuar në ekspozimin ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit dhe ndryshimit të ndodhur në fillim të vitit financiar dhe të mbajtur konstant gjatë gjithë periudhës raportuese. Në vijim është një parashikim i efekteve nga ndryshimi i kursit të këmbimit në humbjen neto, duke mbajtur të gjithë variablat e tjerë konstantë:

	31.12.2023		31.12.2022	
	Vleresohet me 10%	Zhvleresohet me 10%	Vleresohet me 10%	Zhvleresohet me 10%
EUR	(69,710,743)	69,710,743	(74,490,666)	74,490,666
USD	(996)	996	(60,548)	60,548
GBP	(9,797)	9,797	(10,571)	10,571

Kukës International Airport Sh.p.k
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(Vlerat janë në Lek)

26. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2023, shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

27. Veprimet me palet e lidhura

Marredheniet me palet e lidhura të shoqërisë me 31.12.2023 dhe 31.12.2022 paraqiten si vijon:

<i>Pasqyra e Pozicionit Financiar:</i>	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Llogari të arkëtueshme		
Global Technical Mechanics	1,558,200	1,713,450
Ridgers Mema	-	-
	1,558,200	1,713,450
Llogari të pagueshme		
Global Technical Mechanics	(1,178,993,354)	(1,169,932,640)
Ridgers Mema	(11,151,183)	(10,660,165)
	(1,190,144,537)	(1,180,592,805)
Hua		
Global Technical Mechanics	(117,098,442)	(319,862,677)
	(117,098,442)	(319,862,677)
<i>Performanca financiare:</i>	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022
Shitjet		
Global Technical Mechanics	574,000	-
Ridgers Mema	-	-
	574,000	-
Blerjet		
Global Technical Mechanics	7,912,845	180,733,045
Ridgers Mema	-	-
	7,912,845	180,733,045
Shpenzime të tjera		
Global Technical Mechanics	-	-
Ridgers Mema	-	3,156,395
	-	3,156,395
	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022
Përfitimet e drejtimit		
Pagat	3,086,376	3,086,376
Totali	3,086,376	3,086,376

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera përveç sa më sipër, mbas datës së raportimit të cilat mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare.